

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Riparim-mirëmbajtje sisteme ajri të vakumuar dhe komprimuar, tanker oksigjeni, rampa oksigjeni, linjat e pajisjet përkatëse, për nevojat të QSUNT për një periudhë mbulimi 24 muaj”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime mirembajtje dhe riparimi (50000000-5)

VLERA E FONDIT LIMIT:

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: 13,229,579.00 (trembëdhjetë milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH.**

Shumatorja e çmimeve për njësi: 977,023.00 (nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëzet e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “*Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*, Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: *Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:*

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas **Shtojces 2;**

Argumentimi: *Kjo shtojce është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.*

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: *Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: *Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël; Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a) Operatori duhet të ketë certifikatën **ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejmë te percaktuar se:*

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjë mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit / Vleres se Pritshme te Kontrates për të cilin konkuron operatori ekonomik.

****Shënim:** Kur nuk është e mundur shkarkimi nga sistemi e-albania per xhiron vjetore 2023, Operoret Ekonomike pjesëmarrës mund të paraqesin xhiron vjetore per vitet financiare (2020, 2021 dhe 2022).*

***Shënim*:** Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40 % do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar në Seksionin: 2.10 Përshkrim i shkurtër i kontratës/Marrëveshjes Kuadër, pika 1.*

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, ”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rasteve të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”; si dhe ne piken 4 te nenit 55 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 4.[...] Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave [...];

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”; si dhe ne piken 4 te nenit 55 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 4.[...] Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohe në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave [...]. Duke qene se kjo procedure prokurimi bazuar ne vleren e fondit limit nën kufirin e ulët monetar. AK është e vetmja qendër terciare në RSH për këtë arsye praktika e vendosur ndër vite e cila ka rezultuar e suksesshme, është ajo e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik në tërësi.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 61 ‘Deklarata tatimore vjetore’ të ligjit nr. 29, datë 30.03.2023 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata/kontratat perkatese te shoqeruara me vërtetimin e realizimit me sukses te saj/te tyre, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe / ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar në Seksionin: 2.10 Përshkrim i shkurtër i kontratës/Marrëveshjes Kuadër, pika 1.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; në piken 3 të nenit 41 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, në të cilin është e përcaktuar se: [...]. 3. . Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", piken 3 të nenit 41, si dhe në germen b) pika 4 e nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor QSU "Nënë Tereza" Tiranë është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

b) Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e kontratës:

Licensë profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategorine

○ **NS 12-A ; (Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit)**

Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.”

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 te Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe me germen a pika 4 te nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, sherbime”, VKM-së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, lidhja 3 “N.S - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi”, me qellim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per kualifikimin profesional te OE ofertues, te lëshuar nga autoritete kompetente shteterore per veprimtaritë e kërkuara dhe per te cilat duhet te lidhet kontrata.

Ky kriter eshte vendosur edhe ne mbeshtetje te VKM-se nr. 759, datë 12.11.2014 “Per licencimin profesional te individeve dhe subjekteve juridike qe do te ushtrojne veprimtari ne fushen e studimit e te projektimit ne ndertim dhe mbikeqyrjes e kolaudimit te punimeve te zbatimit ne nderti” Lidhja 3/1 “N.S - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.”

c) Operatori ekonomik duhet te deshmoje se ka te punesuar punonjesit me kualifikime teknike nga inspektoriati Shteteror Pergjegjes për Sigurinë e Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike ose nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues) për fushën përkatëse ne specialitetet si me poshte:

- **2 (dy) punonjes elektro-mekanike (me kontratë pune dhe CV e tyre, për mbulimin 24 orësh të shërbimit të gatishmerisë).**
- **2 (dy) punonjes saldator me patente ose çertifikatë (me kontratë pune dhe CV e tyre, për mbulimin 24 orësh të shërbimit të gatishmerisë).**

Shenim: Ky kriter ne fazen e ofertimit te operatoreve ekonomik do te konsiderohet i permbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit permbledhes te vetdeklarimit sipas shtojces 9 te DST. Ne rastet kur OE do te shpallet fitues duhet te paraqese dokumentacionin provues sipas ketij kriteri.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe me germen b dhe c pika 4 te nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Ky kriter mbeshitet edhe ne Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, sherbime”.

Ky kriter eshte plotesuar ne baze te volumit te sherbimeve sipas zerave te sherbimeve, te percaktuara ne preventivin e sherbimeve, specialistët e mësipërm, janë përcaktuar në përputhje me listen e sherbimeve. Pra janë vendosur kërkesa të cilat lidhen ngushtë aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Dëshmia profesionale dhe dëshmia kualifikimit teknik, janë kërkuar nga AK për t’u siguruar në aftësitë e specialistëve për zbatimin korrekt të sherbimeve si dhe që këta specialistë kanë njohuritë e duhura për rregullat e sigurimit teknik në punë.

c) Operatori ekonomik duhet te paraqesi CV e Drejtuesve Teknike, kontrate pune, te figurojne ne licensen e shoqerise, si dhe një deklaratë e cila përcakton se Drejtuesi Teknik është i punësuar pranë kësaj shoqërie me kohë të plotë pune dhe do jetë në dispozicion të realizimit të objektit.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe me germen b dhe c pika 4 te nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Ky kriter mbeshitet edhe ne Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, sherbime”.

d) Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht:

1 (një) inxhinier mekanik me kontratë pune dhe CV

1 (një) inxhinier të kualifikuar për sisteme gazrash mjekësore me kontratë pune dhe CV

Shenim: Ky kriter ne fazen e ofertimit te operatoreve ekonomik do te konsiderohet i permbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit permbledhes te vetdeklarimit sipas shtojces 9 te DST. Ne rastet kur OE do te shpallet fitues duhet te paraqese dokumentacionin provues sipas ketij kriteri.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe me germen b dhe c pika 4 te nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Ky kriter mbeshitet edhe ne Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, sherbime”.

dh) Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmoje se ka ne pronesi mjetet dhe pajisjet teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, nepermjet paraqitjes se faturave tatimore te blerjes ose fatura zhdoganimi kur eshte mall i importuar. Kur mjetet dhe pajisje teknike jane me qira ose ne huaperdorje, nepermjet paraqitjes se kontrates se qirase ose huaperdorjes se bashku me faturen e blerjes se mjetit/pajisjes ose faturen e zhdoganimit kur

pajisja është e importuar nga jashtë. Afati i vlefshmerise per kontraten e qirase/huaperdorjes, duhet te mbuloje afatin e kontrates (Marreveshjes Kuader) se shpallur nga AK. Percaktimet e kesaj pike vlejne per te gjitha mjetet/pajisjet e mepostme:

- **Bombël azoti e pajisur me reduktor.**
- **Saldatrice.**
- **Pompa vakumi serbatorësh oksigjen (tanker)**
- **Kanellë saldimi.**
- **Shkalle alumini me hapje**
- **Shkalle dyshe e vogel.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe me germen ç) pika 4 te nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Ky kriter mbeshtetet edhe ne Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, sherbime”.

Ky kriter është plotësuar ne baze te volumit te sherbimeve sipas zerave te sherbimeve, te percaktuara ne preventivin e sherbimeve, mjetet dhe pajisjet teknike te mësipërme, janë përcaktuar në përputhje me listen e sherbimeve. Pra janë vendosur kërkesa të cilat lidhen ngushtë aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Mjetet dhe pajisjet teknike, janë kërkuar nga AK për t’u siguruar në aftësitë teknike për zbatimin korrekt të sherbimeve.

e) Autodeklarate nga ofertuesi qe të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, duhet të jenë të çertifikuara (CE) ose (FDA).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjën mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Ky kriter është vendosur per te garantuar Autoritetin Kontraktor ne lidhje me cilesine e materialeve qe do te perdoren gjate kryerjes se sherbimeve te kerkuara. Certifikimi i produktit (vendosja e Markës CE ose FDA) është një procedurë që ka për synim të vërtetojë se procesi i prodhimit të një produkti është kaluar në shqyrtim, dhe deklaron që produkti është vlerësuar përpara futjes në treg dhe është në përputhje me gjithë kushtet ligjore evropiane dhe/ose vendase. Certifikimi i produktit (vendosja e Markës CE ose FDA) kërkohet për shumë produkte. Vendosja e Markës CE ose FDA

tregon përputhshmërinë e një produkti me standardet specifike të Bashkimit Evropian dhe mundëson lëvizjen e lirë të produktit brenda tregut evropian. Përveç Certifikimit të Sistemit të Menaxhimit, Përputhshmëria e Markës CE ose FDA nuk është një proces vullnetar. Vendosja e Markës CE ose FDA mbi një produkt të eksportuar në Evropë përbën detyrim ligjor për çdo prodhues. Duke shfaqur markën CE ose FDA mbi një produkt, prodhuesi tregon se ai ka: Vërtetuar se produkti është në përputhje me kushtet themelore përkatëse (p.sh. shëndetësore, të sigurisë apo mjedisore) të përcaktuara në direktivat e zbatueshme dhe nëse e përcaktuar në direktivë, ka kaluar ekzaminimin nga një organ të pavarur të vlerësimit të përputhshmërisë.

ë) Autodeklarate nga ofertuesi që të gjitha materialet që do të përdoren për riparime dhe furnizim vendosje dhe që i nënshtrohen kërkesave të ligjit nr. 89/2014 “Per pajisjet mjekesore” i ndryshuar, duhet të jenë të regjistruara me certifikatë regjistrimi pranë “Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)” sipas parashikimeve të këtij ligji.

(Sqarim: Materialet e lartpërmendura janë të gjitha ato materiale që sipas kërkesave të ligjit nr. 89/2014 duhet të jene të regjistruara dhe të pajisura me certificate prane AKBPM)

Argumentimi: Ky kriter është miratuar dhe vendosur nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit që ka specialitetin përkatës në lidhje me kriteret teknike, në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, VKM nr. 295, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, Njoftimi i APP-së, me nr.2502prot., datë 09.04.2021, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik“, rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive“, të Ligjit nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore”. E vetmja Agjenci Shtetërore e cila bën regjistrimin e pajisjeve mjekesore në Shqipëri është Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekesore për të cilën edhe grupi i punës sipas specialiteteve përkatëse ka përcaktuar këto kriter të cilët garantojnë këto përmbushje standardesh teknike etj., Njësia e prokurimit vendos kriterin e sipër cituar, ku kërkon që OE fitues që të plotësojë këto kriter, në mënyrë që AK të sigurohet që subjekti/shoqëria që do të kryej furnizimin, jep garancinë për këto pajisje do të bëhet regjistrimin pranë Agjencisë së Barnave dhe Pajisjeve Mjekesore.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“Riparim-mirëmbajtje sisteme ajri të vakuumuar dhe komprimuar, tanker oksigjeni, rampa oksigjeni, linjat e pajisjet përkatëse” për nevojat të QSUNT për një periudhë mbulimi 24 muaj”

Nr.	Emërtimi	Njësia
I	Sistemet e furnizimit me ajër të komprimuar	
1	Shërbime teknike në kompresor ajri	Orë pune
2	Shërbime teknike në linja komprimimi, panele automatike shkalla I dhe II deri te shtrati I pacientit	Orë pune
3	Riparim priza ajri komprimuar SA7 ne salla operacioni	Orë pune
4	Riparim prize ajri 5bar te pacienti	Orë pune
5	F.v. filtro vaji	Copë
6	F.v. filtro ajri	Copë
7	F.v. vaj për kompresor sipas specifikimeve teknike ISO VG 100/1-4lt, ME-30-6lt,180 6743-3A-DAB-10lt dhe që jepen me urdhër pune	litra
8	Filter ndares	Copë
9	Filtra linje ajri	Copë
10	Filtra karboni tub per heqje lageshtire kit	Copë
11	Shkarkues automatik lageshtire	Copë
12	F.v kit prize ajri	Copë
13	F.v. llampa sinjalizimi	Copë
14	F.v. butona lëshimi	Copë
15	F.v. lëshues me rele termike	cope
16	F.v. saraçineska bakri përdorim spitalor 1/2"	Copë
17	F.v. rakorderi bakri përdorim spitalor	kg
18	F.v. kushineta (sipas faktit jepen me urdher pune)	Copë
19	Tubo bakri per perdorim spitalor	ml
20	F.v Inesto ajer i komprimuar	Cope
21	Manometer Presioni	Cope
22	Tub Fleksiel presioni	ml
23	Presostat	Cope
24	Avolzhim elektromotorri	Cope
25	Riparime ne grup kompresori	Cope
26	Tub gome medikal	ml
II	Sistemet e furnizimit me ajër të vakumuar	
1	Shërbime teknike në pompa vakumi	Orë pune
2	Shërbime teknike në linja vakumi, panele automatike shkalla I dhe II deri te shtrati I pacientit	Orë pune
3	Riparim prize vakumi dhe vakumetrave	Orë pune
4	F.v. filtro e centralit të vakumit CMV 180-00	Copë
5	F.v. vaj për centrale vakumi sipas specifikimeve teknike ISO VG 100/1-4lt, ME-30-6lt,180 6743-3A-DAB-10lt dhe që jepen me urdhër pune	litra

6	Filter vaji	Copë
7	Filtra linje antibakterial kit	Copë
8	F.v elika te pompave te vakumit	Copë
9	F.v. Vakumeter	Cope
10	F.v. Kite prize vakumi	Cope
11	F.v prize Agss pavion	Cope
12	F.v Inesto vakumi	Cope
13	F.v vazo vakumi	Cope
14	F.v. xhunto plastike	Copë
15	Vuotostat	Cope
16	Tub bakri	ml
17	Panel komandimi elektronik pompash	Cope
18	Avolzhim elektomotorri	Cope
19	Riparim pompe vakumi	Cope
20	Tub gome medikal per ajer.	ml
III	Sistemet e furnizimit me oksigjen dhe shërbimet në Tankerat e oksigjenit	
1	Dhenie vakumi me elektropompe centrale per krijim vakumi te tankerit 11.000 litersh te oksigjenit te lengshem te Spitalit nr.1	Orë pune makinerie vakumi
2	Kontroll teknik i valvolave te sigurimit	Orë pune
3	Kontrolli dhe shërbim i rampave të gatishmërisë, linjave, paneleve, manometrave, reduktoreve të shkallës I+II, deri tek shtrati i pacientit.	Orë pune
4	Riparim priza oksigjeni, fluksimetra.	Orë pune
5	F.v. tubo bakri për përdorim spitalor Ø12	ml
6	F.v. tubo të gomuar fleksibëli për përdorim spitalor Ø 12 me pipeta dhe fasheta	ml
7	F.v. tubo bakri për përdorim spitalor fi 16	ml
8	F.v. tubo bakri për përdorim spitalor Ø 22	ml
9	F.v. aksesore, gomina, fasheta e rekorde bakri	cope
10	F.v. priza oksigjeni	cope
11	F.v. lagështues oksigjeni	cope
12	F.V Kit per panel reduktori shkalles pare	cope
13	F.v. reduktor të shkallës së dyte te sistemit të oksigjenit	cope
14	Saracineksa linje	cope
15	Manometer presioni	cope
16	F.v. gota lagështuesi oksigjeni	cope
17	F.v. Kite prize oksigjeni pavion	cope
18	F. Bombel oksigjeni me karroce per pacient	cope
19	F.v Inesto oksigjeni	cope
20	F.v fluksimeter	cope
21	Reduktor oksigjeni me fluksimeter	cope

22	Tub gome medikal per oksigjen	ml
23	Alarm Gazrash Mjekstore	cope
24	Sensore alarmi	cope

Hyrje

QSUNT është një objekt i kategorisë së parë nga shkalla e rëndësisë së veçantë dhe objektet e kësaj procedure janë jetike e të rëndësishme, pasi janë të lidhura direkt me aktivitetin shëndetësor të institucionit.

Sistemi i shpërndarjes së gazrave mjekësor është një element themelor për çdo institucion shëndetësor, pasi mundëson garantimin e vazhdueshmërisë operacionale të furnizimit me gaz mjekësor (oksigjen, ajër mjekësor) dhe aspirimin me vakum, duke siguruar gjithmonë një trajtim të sigurt dhe efikas të pacientëve.

Shërbimi i riparimeve dhe mirëmbajtjes është një aktivitet kompleks dhe një politikë e saktë e mirëmbajtjes sjell përfitime në:

- sigurinë e pacientëve për sa i përket vazhdimësisë së furnizimit dhe cilësisë së gazrave të administruar;
- sigurinë e punonjësve teknikë dhe shëndetësorë për vazhdueshmërinë e aktivitetit dhe/ose menaxhimit të situatave emergjente;
- uljen e kostove për Autoritetin Kontraktor nga optimizimi i procesit të mirëmbajtjes me rrezikshmeri më të ulët të dështimeve të papritura dhe humbje të gazeve apo energjisë elektrike;
- mjedis me më pak ndotje duke parandaluar rrjedhje në mjedisi të gazit mjekësor.

Specifikime teknike

- Operatori Ekonomik që do të kryejë shërbimet e riparim- mirëmbajtjes, duhet të ketë personel teknik të kualifikuar dhe të specializuar në mënyrë që të garantojë kryerjen e saktë të këtyre shërbimeve sipas standardeve UNI EN ISO 7396-1 2016 .
- Aktivitetet e riparim-mirëmbajtjes dhe furnizim-vendosjes duhet të kryhen në përputhje me udhëzimet e ofruara nga prodhuesi i këtyre sistemeve dhe specifikimeve teknike përkatëse .
- Aktivitetet që do të duhet të kryejë OE përfshijnë:
 - **Kontrolle periodike të planifikuara:** kontrollet, testimet, rregullimet, zëvendësimet, pastrimin dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për të garantuar funksionimin dhe sigurinë në këto sisteme.
 - Çdo sistem duhet t'i nënshtrohet kontrolleve periodike të planifikuara, për të vlerësuar gjendjen e performancës dhe funksionit të tyre, me frekuencë sipas specifikës teknike të çdo pajisjeje, referuar udhëzimeve të ofruara nga vetë prodhuesi si dhe udhëzimeve të A.K

. Po ashtu zëvendësimi i pjesëve të këmbimit të dëmtuara do të bëhet me urdhëra pune pas vlerësimit të defektit.

- Shërbimet teknike të planifikuara do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe diela, në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, sipas udhëzimeve nga AK, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.

- **Defektet e çastit:** Riparim-shërbimet do të kryhen me marrjen e njoftimit, menjëherë, çdo ditë dhe në çdo orë.

- Të gjitha pjesët/zërat për furnizim-vendosje duhet të jenë të markuara CE dhe në përputhje me llojin e përshkruar nga prodhuesi i pajisjes ku do të zëvendësohen/ndërrohen.

Zëri shërbime teknike në kompresorët e ajrit dhe në linjat e komprimimit konsiston kryesisht në këto kontrolle dhe shërbime parësore:

- Kontroll vizual i gjendjes së përgjithshme të kompresorëve, tharëse.
- Kontroll i nivelit të vajit në kompresor.
- Kontroll i gjendjes së filtrave të vajit e të ajrit.
- Kontroll i jashtëm i gjendjes së motorrëve elektrikë.
- Kontroll i gjendjes fizike i rripave të transmisionit.
- Kontrolli i paneleve të automatikës, tarimi i tyre, vënia në punë me presostat.
- Kontroll i lëshuesave.
- Kontroll i manometrave dhe depozitave.
- Kontroll i filtrave të lagështirës.
- Kontroll i reduktorëve të presionit.
- Kontroll i valvulave elektrike në çisterna.

Zëri shërbime teknike në pompat dhe në linjat e vakumit konsiston kryesisht në këto kontrolle dhe shërbime parësore:

- Kontroll i gjendjes së pompave të vakumit nga ana elektrike dhe mekanike.
- Kontroll i paneleve kryesore elektrike.
- Kontroll i filtrave të vajit e të ajrit.
- Kontroll i manometrave të presionit në linjë e në depozitë.

Zëri kontrolli dhe shërbim i rampave të gatishmërisë, linjave, paneleve, manometrave të oksigjenit konsiston kryesisht në:

- Kontroll i rampave të emergjencës.
- Kontroll i linjave.
- Kontroll i reduktorit kryesor.
- Kontroll i valvulave të sigurisë.

Kontroll i manometrave.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë miratuar në baze të kërkesës “Për hapje procedure” me nr. 215/9 prot, datë 23.02.2024 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbeshtetese në QSUT dhe

dokumentacionit bashkelidhur saj dhe janë përcaktuar / vendosur në relacionin për argumentimin e fondit limit si dhe hartimin e specifikimeve teknike me nr. 215/8 prot.,date 16.02.2024 referuar Urdhërit me Nr. Prot. 215/1 (nr.28), datë 29.01.2024, plotësuar me shkresën nr. 215/11 prot., datë 18.03.2024 „Kthim përgjigje shkresës (...);“, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Shtojca 6

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia për 24 muaj
I	Sistemet e furnizimit me ajër të komprimuar		
1	Shërbime teknike në kompresor ajri	Orë pune	2610
2	Shërbime teknike në linja komprimimi, panele automatike shkalla I dhe II deri te shtrati I pacientit	Orë pune	634
3	Riparim priza ajri komprimuar SA7 ne salla operacioni	Orë pune	275
4	Riparim prize ajri 5bar te pacienti	Orë pune	1480
5	F.v. filtro vaji	Copë	52
6	F.v. filtro ajri	Copë	52
7	F.v. vaj për kompresor sipas specifikimeve teknike ISO VG 100/1-4lt, ME-30-6lt,180 6743-3A-DAB-10lt dhe që jepen me urdhër pune	litra	280
8	Filter ndares	Copë	42
9	Filtra linje ajri	Copë	28
10	Filtra karboni tub per heqje lageshtire kit	Copë	6
11	Shkarkues automatik lageshtire	Copë	13
12	F.v kit prize ajri	Copë	20
13	F.v. llampa sinjalizimi	Copë	39
14	F.v. butona lëshimi	Copë	16
15	F.v. lëshues me rele termike	cope	11
16	F.v. saraçineska bakri përdorim spitalor 1/2"	Copë	32
17	F.v. rakorderi bakri përdorim spitalor	kg	14
18	F.v. kushineta (sipas faktit jepen me urdher pune)	Copë	30

19	Tubo bakri per perdorim spitalor	ml	20
20	F.v Inesto ajer i komprimuar	Cope	5
21	Manometer Presioni	Cope	6
22	Tub Fleksiel presioni	ml	11
23	Presostat	Cope	10
24	Avolzhim elektromotorri	Cope	6
25	Riparime ne grup kompresori	Cope	4
26	Tub gome medikal	ml	20
II	Sistemet e furnizimit me ajër të vakumuar		
1	Shërbime teknike në pompa vakumi	Orë pune	2632
2	Shërbime teknike në linja vakumi, panele automatike shkalla I dhe II deri te shtrati I pacientit	Orë pune	282
3	Riparim prize vakumi dhe vakumetrave	Orë pune	730
4	F.v. filtro e centralit të vakumit CMV 180-00	Copë	18
5	F.v. vaj për centrale vakumi sipas specifikimeve teknike ISO VG 100/1-4lt, ME-30-6lt, 180 6743-3A-DAB-10lt dhe që jepen me urdhër pune	litra	280
6	Filter vaji	Copë	52
7	Filtra linje antibakterial kit	Copë	4
8	F.v elika te pompave te vakumit	Copë	25
9	F.v. Vakumeter	Cope	8
10	F.v. Kite prize vakumi	Cope	90
11	F.v prize Agss pavion	Cope	2
12	F.v Inesto vakumi	Cope	5
13	F.v vazo vakumi	Cope	30
14	F.v. xhunto plastike	Copë	17
15	Vuotostat	Cope	5
16	Tub bakri	ml	3
17	Panel komandimi elektronik pompash	Cope	2
18	Avolzhim elektomotorri	Cope	5
19	Riparim pompe vakumi	Cope	5
20	Tub gome medikal per ajer.	ml	20
III	Sistemet e furnizimit me oksigjen dhe shërbimet në Tankerat e oksigjenit		
1	Dhenie vakumi me elektropompe centrale per krijim vakumi te tankerit 11.000 litersh te oksigjenit te lengshem te Spitalit nr.1	Orë pune makinerie vakumi	200
2	Kontroll teknik i valvolave te sigurimit	Orë pune	262

3	Kontolli dhe shërbim i rampave të gatishmërisë, linjave, paneleve, manometrave, reduktoreve të shkallës I-II, deri tek shtrati i pacientit.	Orë pune	1780
4	Riparim priza oksigjeni, fluksimetra.	Orë pune	2710
5	F.v. tubo bakri për përdorim spitalor Ø12	ml	20
6	F.v. tubo të gomuar fleksibëli për përdorim spitalor Ø 12 me pipeta dhe fasheta	ml	60
7	F.v. tubo bakri për përdorim spitalor fi 16	ml	10
8	F.v. tubo bakri për përdorim spitalor Ø 22	ml	30
9	F.v. aksesore, gomina, fasheta e rekorde bakri	cope	50
10	F.v. priza oksigjeni	cope	40
11	F.v. lagështues oksigjeni	cope	55
12	F.V Kit per panel reduktori shkalles pare	cope	6
13	F.v. reduktor të shkallës së dyte te sistemit të oksigjenit	cope	7
14	Saracineksa linje	cope	23
15	Manometer presioni	cope	14
16	F.v. gota lagështuesi oksigjeni	cope	120
17	F.v. Kite prize oksigjeni pavion	cope	190
18	F. Bombel oksigjeni me karroce per pacient	cope	14
19	F.v Inesto oksigjeni	cope	5
20	F.v fluksimeter	cope	30
21	Reduktor oksigjeni me fluksimeter	cope	12
22	Tub gome medikal per oksigjen	ml	20
23	Alarm Gazrash Mjeksore	cope	4
24	Sensore alarmi	cope	8

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Sasia dhe grafiku i shërbimit do të ekzekutohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

- **Kontrolle periodike të planifikuara:** kontrollet, testimet, rregullimet, zëvendësimet, pastrimin dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për të garantuar funksionimin dhe sigurinë në këto sisteme.

- Çdo sistem duhet t'i nënshtrohet kontrolleve periodike të planifikuara, për të vlerësuar gjendjen e performancës dhe funksionit të tyre, me frekuencë sipas specifikës teknike të çdo pajisjeje, referuar udhëzimeve të ofruara nga vetë prodhuesi si dhe udhëzimeve të A.K. Po ashtu zëvendësimi i pjesëve të këmbimit të dëmtuara do të bëhet me urdhëra pune pas vlerësimit të defektit.
- Shërbimet teknike të planifikuara do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe diela, në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, sipas udhëzimeve nga AK, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.

- **Defektet e çastit:** Riparim-shërbimet do të kryhen me marrjen e njoftimit, menjëherë, çdo ditë dhe në çdo orë.

Argumentimi: Sasia dhe Grafiku i levrimit janë vendosur në bazë të kërkesës “Për hapje procedure” me nr. 215/9 prot, datë 23.02.2024 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbeshtetese në QSUT dhe dokumentacionit bashkelidhur saj dhe janë përcaktuar / vendosur në relacionin për argumentimin e fondit limit si dhe hartimin e specifikimeve teknike me nr. 215/8 prot., date 16.02.2024 referuar Urdhërit me Nr. Prot. 215/1 (nr.28), datë 29.01.2024, plotësuar me shkresën nr. 215/11 prot., datë 18.03.2024 „Kthim përgjigje shkresës (...);“, si dhene perputhje me piken 3, germa c te nenit 15 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Shtojca 7

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Riparim-mirëmbajtje sisteme ajri të vakumuar dhe komprimuar, tanker oksigjeni, rampa oksigjeni, linjat e pajisjet përkatëse” për nevojat të QSUNT për një periudhë mbulimi 24 muaj”**

Detyrat:

- Operatori Ekonomik që do të kryejë shërbimet e riparim- mirëmbajtjes, duhet të ketë personel teknik të kualifikuar dhe të specializuar në mënyrë që të garantojë kryerjen e saktë të këtyre shërbimeve sipas standardeve UNI EN ISO 7396-1 2016 .

- Aktivitetet e riparim-mirëmbajtjes dhe furnizim-vendosjes duhet të kryhen në përputhje me udhëzimet e ofruara nga prodhuesi i këtyre sistemeve dhe specifikimeve teknike përkatëse .

- Aktivitetet që do të duhet të kryejë OE përfshijnë:

- **Kontrolle periodike të planifikuara:** kontrollet, testimet, rregullimet, zëvendësimet, pastrimin dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për të garantuar funksionimin dhe sigurinë në këto sisteme.

- Çdo sistem duhet t'i nënshtrohet kontrolleve periodike të planifikuara, për të vlerësuar gjendjen e performancës dhe funksionit të tyre, me frekuencë sipas specifikës teknike të çdo pajisjeje, referuar udhëzimeve të ofruara nga vetë prodhuesi si dhe udhëzimeve të A.K . Po ashtu zëvendësimi i pjesëve të këmbimit të dëmtuara do të bëhet me urdhëra pune pas vlerësimit të defektit.

- Shërbimet teknike të planifikuara do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe diela, në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, sipas udhëzimeve nga AK, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.

- **Defektet e çastit:** Riparim-shërbimet do të kryhen me marrjen e njoftimit, menjëherë, çdo ditë dhe në çdo orë.

- Të gjitha pjesët/zërat për furnizim-vendosje duhet të jenë të markuara CE dhe në përputhje me llojin e përshkruar nga prodhuesi i pajisjes ku do të zëvendësohen/ndërrohen.

Zëri shërbime teknike në kompresorët e ajrit dhe në linjat e komprimimit konsiston kryesisht në këto kontrolle dhe shërbime parësore:

- Kontroll vizual i gjëndjes së përgjithshme të kompresorëve, tharëse.
- Kontroll i nivelit të vajit në kompresor.
- Kontroll i gjëndjes së filtrave të vajit e të ajrit.
- Kontroll i jashtëm i gjëndjes së motorëve elektrikë.
- Kontroll i gjëndjes fizike i rripave të transmisionit.
- Kontrolli i paneleve të automatikës, tarimi i tyre, vënia në punë me presostat.
- Kontroll i lëshuesave.
- Kontroll i manometrave dhe depozitave.
- Kontroll i filtrave të lagështirës.
- Kontroll i reduktorëve të presionit.
- Kontroll i valvulave elektrike në çisterna.

Zëri shërbime teknike në pompat dhe në linjat e vakumit konsiston kryesisht në këto kontrolle dhe shërbime parësore:

- Kontroll i gjëndjes së pompave të vakumit nga ana elektrike dhe mekanike.
- Kontroll i paneleve kryesore elektrike.
- Kontroll i filtrave të vajit e të ajrit.
- Kontroll i manometrave të presionit në linjë e në depozitë.

Zëri kontolli dhe shërbim i rampave të gatishmërisë, linjave, paneleve, manometrave të oksigjenit konsiston kryesisht në:

- Kontroll i rampave të emergjencës.
- Kontroll i linjave.
- Kontroll i reduktorit kryesor.
- Kontroll i valvulave të sigurisë.

Kontroll i manometrave.

Shpërndarja: 24 muaj nga nenshkrimi i marreveshjes kuader, pranë godinave përkatëse të Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë, sipas inventarit më poshtë:

Inventari i pjesëve kryesore të sistemit të ajrit të vakumuar, të kompresuar dhe linjave të oksigjenit.

Viti 2024		Pajisjet kryesore të instaluar (copë)					
Nr.	Godinat spitalore ku janë instaluar pajisjet	Kompresor	Pompë vakumi	Rampë oksigjeni	Priza dalje O2	Priza dalje Ajri	Priza dalje Vakumi
1	Neurokirurgji+Neurologji	4	8	1	105	87	100
2	Pediatri	3	3	1	90	56	56
3	Spitali Francez	3	3	1	50	30	30
4	Kardiokirurgji e Kirurgjia Vaskulare (6 katëshi)	5	11	Rampa e Sp. Francez	79	25	25
5	Spitali A1	3	3	1	189	189	189
6	Spitali Qendror (A2)	3	3	1	350	350	345

7	Djegje- Plastika	2	2	Rampa e Sp. Onkologjik	9	9	9
8	Onkologjik	1	0	1	19	7	0
9	Infektiv	3	3	1	125	125	125
10	Spitali ish Kirurgjite	Kompresoret e Sp.A1	Pompat e Sp.A1	Rampat e Sp.A1	120	38	90
	Totali	27	36	7			

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë

Argumentimi: Termat e referencës janë vendosur në bazë të shkresës nr. 215/8 prot., datë 16.02.2024, plotësuar me shkresën nr. 215/11 prot., datë 18.03.2024 „Kthim përgjigje shkresës (...);“, nga Komisioni i argumentimit të fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike, bashkelidhur kërkeses për hapje procedure nga Drejtoria e Shërbimeve Mbeshtetese me nr. 215/9 prot, datë 23.02.2024, të miratuara dhe nga Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe në përputhje me piken 3, germa c të nenit 15 dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT: